

**Akti i Themelimit i
"T.D.A." sh.p.k.**

Në mbështetje të legjislacionit shqiptarë, në ligjin nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", në dokument referuar si "Ligji", hartohet Akti i Themelimit, me kushtet që përcaktohen si më poshtë:

**Neni 1
Baza ligjore**

Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar T.D.A., në vijim referuar si "Shoqëria" themelohet sipas formës dhe kuptimit të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", pjesa IV – Shoqëritë me Përgjegjësi të Kufizuar, si dhe në përputhje të plotë me Kodin Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2
Emërtimi**

Shoqëria quhet T.D.A..

**Neni 3
Sigla (Logo)**

Forma dhe përmbajtja e siglës (logos) përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë.

**Neni 4
Vula**

Forma dhe përmbajtja e vulës përcaktohet nga organet drejtuese të shoqërisë. Vula figuron në të gjitha shkresat dhe korrespondencën që del prej shoqërisë. Vula mbahet dhe administrohet nga Drejtori Ekzekutiv.

**Neni 5
Selia**

Selia është në adresën: Rruga "Qemal Stafa", godina 2, hyrja 3, njesia 17, Tiranë, Shqipëri. Kjo adresë mund të ndryshojë në varësi të veprimtarisë së shoqërisë.

**Neni 6
Faqja web**

Faqja web është www.T.D.A..al.

Neni 7
Posta elektronike

Posta elektronike që mund të përdoret për qëllime të komunikimit elektronik është info@T.D.A..al.

Neni 8
Kohëzgjatja

Shoqëria do të veprojë në një afat kohor të pacaktuar. Përfundimi i veprimtarisë bëhet me vendim të Bordit të Aksionerëve.

Neni 9
Qëllimi dhe Fushat e veprimtarisë

Shoqëria aspiron të realizojë aktivitetet e mëposhtme:

1. Administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit.
2. Kuptimin e nevojave të konsumatorëve dhe ofrimin e mundësive teknologjike që i plotësojnë këto nevoja.
3. Planifikimin e përdorimit efektiv dhe strategjik të teknologjive të reja, në shërbim të biznesit dhe shoqërisë.
4. Ofrimin e shërbimeve që plotësojnë kërkesën konsumatore.

Neni 10
Data e themelimit

Shoqëria themelohet më datë 19 tetor 2021.

Neni 11
Themeluesi

Shoqëria krijohet me Aktin e Themelimit, nënshkruar me vullnetin dhe iniciativën e lirë të themeluesit të saj të vetëm Z. Xhulian Balla.

Neni 12
Kapitali fillestarë

Kapitali themeltar fillestarë i shoqërisë është 100 Lekë, i përbërë nga 1 kuotë e vetme me vlerë 100 Lekë. Kapitali përbëhet 100% nga kontributi i themeluesit të vetëm të shoqërisë.

Neni 13
Organet drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Bordi i Ortakëve
2. Drejtori Ekzekutiv

Organi i vetëm vendimmarrës i T.D.A. SH.P.K. është Bordi i Ortakëve.
Drejtor Ekzekutiv emërohet ortaku i vetëm Z. Xhulian Balla, i biri i Zihniut, lindur në Librazhd më 22.03.1995, banues në Tiranë.

Neni 14
Përfaqësimi ligjor

Perfaqesues ligjor i Shoqërisë është Drejtori Ekzekutiv. Nëse ai për arsye të ndryshme nuk është i disponueshëm, ia kalon këtë të drejtë një punonjësi tjetër të Shoqërisë me anë të një dokumenti të shkruar, ku përcakton shprehimisht kompetencat që ka deleguar dhe shtrirjen kohore të vlefshmërisë së delegimit.

Ky Akt hartohet në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Tiranë, më 19 tetor 2021 .

Themeluesi:

Xhulian Balla

